



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr. 25/2023
Prishtinë, më 27.7.2023, në orën 19:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, kryetar i Komisioni, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Mërgim Lushtaku, nënkryetar, Pal Lekaj, Ferat Shala dhe Avdullah Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Egzona Tërdevci këshilltare LVV, Elsa Krasniqi asistente LVV.

Stafi mbështetës i Komisionit: Elfete Alshiqi-Beqiri, Sabrije Saliuki- Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, pas votimit konstatoi se komisioni me shumicë votash miratoi rendin e ditës.

2.Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Kryetari, Projektligji nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është shqyrtuar nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisioni ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në bazë të Deklaratës Financiare, vlerëson se zbatimi i Projektligjit krijon kosto shtesë buxhetore për vitin 2023 dhe planifikohet te ketë kosto shtesë 26,250,000 euro. Ndërsa, për vitet 2024-2026, është planifikuar shuma prej 180,000,000 euro në dokumentin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për periudhën 2024-2026. Ndërsa, sa i përket viteve vijuese nga viti 2027 e tutje për këtë skemë të re pensionale, planifikimet buxhetore duhet të bëhen me proces të rregullt buxhetor.

Pasi, qe nuk pat të paraqitur për diskutim, kryetari pas votimit konstatoi se komisioni me shumice votash nxori këtë rekomandim për Komisionin funksional:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përmban implikime buxhetore shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Të ndryshme

Pasi qe nuk pati të paraqitur për diskutim për këtë pikë, kryetari e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 19:20.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit